



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

PA1.nr.983/20

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS, – kolegji i përbërë nga gjyqtarët: Hashim Çollaku, kryetar i kolegjit, Shqipe Qerimi dhe Ferit Osmani, anëtarë, me pjesëmarrjen e bashkëpunëtorit profesional Bujar Ahmeti procesmbajtës, në çështjen penale kundër të akuzuarit N.TH. nga ..., Komuna e Glllogocit, për shkak të veprës penale Kanosje nga neni 181 par.2 të KPRK, dhe Sulmi nga neni 184 par.1 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës duke vendosur sipas ankesës së mbrojtësit të akuzuarit N.TH., av.Skender Zariqi, të paraqitur kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë – Dega në Glllogoc, P.nr.228/2020 të datës 17.09.2020, në seancën e kolegjit të mbajtur më 14.12.2020, mori këtë:

A K T G J Y K I M

I. Me aprovimin e ankesës së mbrojtësit të akuzuarit N.TH., av. Skender Zariqi, **ndryshohet** aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë – Dega në Glllogoc, P.nr.228/2020 i datës 17.09.2020 vetëm përkitazi me vendimin për dënim, ashtu që Gjykata e Apelit të akuzuarit N.TH. për veprat penale Kanosje nga neni 181 par.2 të KPRK-së dhe Sulmi nga neni 184 par.1 KPRK-së për të cilat është shpallur fajtor, dënimet e shqiptuara veç e veç për veprat e lartcekura penale dhe dënimin unik të shqiptuar ia merr si të vërtetuar, ndërsa ndryshohet dënimi i zëvendësuar me gjobë ashtu që tani i shqipton dënim me gjobë në lartësi prej 1.000 (njëmijë) €, të cilën shumë i akuzuari do ta paguaj në afat prej 15 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, e nëse i akuzuari në afatin e caktuar nuk dëshiron ose nuk mund të paguaj gjobën, gjykata mund të zëvendësoj dënimin me gjobë me dënim me burg, i cili për çdo 20 (njëzet) € gjobë do të llogaritet me një ditë burgim.

II. Aktgjykimi në pjesët tjera mbetet i pandryshuar.

A r s y e t i m i

Gjykata Themelore në Prishtinë – Dega në Glllogoc, me aktgjykimin P.nr.228/2020 të datës 17.09.2020, të akuzuarin N.TH. e ka shpallur fajtor për veprën penale Kanosje nga neni 181 par.2 të KPRK-së e ka gjykuar me dënim me burgim në kohëzgjatje prej 4 (katër) muaj, dhe për veprën

penale Sulmi nga neni 184 par.1 të KPRK-së, e ka gjykuar me dënim me burgim në kohëzgjatje prej 3 (tre) muaj. Në bazë të nenit 76 par.1 lidhur me par.2 nënpar. 2.2. të KPRK-së, gjykata i cakton dënim unik me burg në kohëzgjatje prej 6 (gjashtë) muaj. Pasi që gjykata i ka caktuar dënimin unik me burg në kohëzgjatje prej 6 (gjashtë) muaj, i pandehuri në bazë të nenit 44 par.1 të KPRK-së, ka dhënë pëlqimin që dënimi unik me burg në kohëzgjatje prej 6 (gjashtë) muaj, të i zëvendësohet me dënim me gjobë. Në bazë të nenit 43 të KPRK-së, gjykata i shqipton dënim me gjobë të akuzuarit N.TH. në shumë prej 2.000 (dymijë) €, të cilin do të e paguaj në afat prej 15 ditë, nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi. Nëse i akuzuari në afatin e caktuar nuk dëshiron ose nuk mund të paguaj gjobën, gjykata mund të zëvendësoj dënimin me gjobë me dënim me burg, i cili për çdo 20 € gjobë do të llogaritet me një ditë burgim . Nëse i akuzuari në afatin e caktuar nuk dëshiron ose nuk mund të paguaj gjobën në tërësi, gjykata do të zëvendësoj pjesën e mbetur të gjobës me dënim me burgim, ose gjykata me pëlqimin e të akuzuarit në vend të shqiptimit të dënimit me burg, të e zëvendësoj dënimin me gjobë me urdhër për punë në dobi të përgjithshme. Urdhëri për punë të përgjithshme llogaritet ashtu që 8 (tetë) orë të punës në dobi të përgjithshme llogariten 20 € gjobë. Koha e kaluar në ndalim policor në kohëzgjatje prej 3 (tre) ditë dhe atë prej dt. 15.09.2020 e deri më dt. 17.09.2020 të akuzuarit do ti llogaritet në dënimin e shqiptuar me gjobë. I akuzuari është obliguar që në emër të paushallit gjyqësor të paguaj shumën prej 50 €, për programin për Kompensimin e Viktimave të Krimit të paguaj taksën në shumë prej 30 €, të gjitha këto në afat prej 15 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, e nën kanosjen e përmbarimit me dhunë. I dëmtuari A.H. nga ..., Komuna e Skenderajt për realizimin e kërkesës pasurore juridike lidhur me kompensimin e dëmit të shkaktuar me këtë veprë penale nuk ka parashtruar kërkesë. I dëmtuari F.H. nga ..., Komuna e Skenderajt për realizimin e kërkesës pasurore juridike lidhur me kompensimin e dëmit të shkaktuar me këtë veprë penale udhëzohet në kontest civil.

Kundër këtij aktgjykimi brenda afatit ligjor ankesë ka paraqitur mbrojtësi i të akuzuarit N.TH., av. Skender Zariqi për shkak të vendimit mbi dënimin, me propozim që Gjykata e Apelit në Prishtinë aktgjykimin e ankimuar ta ndryshoj dhe ndaj të akuzuarit të shqiptoj vërejtje gjyqësore.

Prokurori i Apelit, me parashtresën me shkrim PPA/II.nr.996/2020, datë 20.10.2020, ka propozuar që ankesa e mbrojtësit të akuzuarit të refuzohet si e pa bazuar, kurse aktgjykimi i ankimuar të vërtetohet.

Gjykata e Apelit, pasi shqyrtoj të gjitha shkresat e kësaj çështje juridiko-penale, studioj aktgjykimin e ankimuar në kuptim të nenit 394 të KPPK-së, dhe pas vlerësimeve të pretendimeve në ankesë, gjeti se:

Ankesa është e bazuar.

Edhe pse aktgjykimi i shkallës së parë nuk kundërshtohet për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës penale, Gjykata e Apelit të njëjtin sipas detyrës zyrtare e shqyrtoi në këtë aspekt konform dispozitës së nenit 394 të KPP dhe konstatoi se ai nuk përmban shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale të cilat do të kushtëzonin anulimin e tij dhe as shkelje të ligjit penal në dëm të akuzuarit.

Po ashtu, as gjendja faktike nuk ka qenë objekt vlerësimi i kësaj Gjykate, në fakt me ankesë as që ka mund të kontestohet ngase i akuzuari në shqyrtimin fillestar e ka pranuar fajësinë në të gjitha pikat e saj dhe gjyqtari individual është pajtuar me një pohim të tillë, prandaj aktgjykimi i kundërshtuar u vlerësua vetëm në drejtim të pretendimeve të paraqitura në ankesë.

Mbrojtësi i të akuzuarit N.TH., av. Skender Zariqi me ankesë e kundërshton aktgjykimin e ankimuar sa i përket vendimit për dënim, duke pretenduar se dënimi i shqiptuar nga gjykata e shkallës së parë ndaj të akuzuarit është dënim i lartë, duke pasur parasysh faktin se i akuzuari rastësisht ka rënë nën ndikimin e alkoolit dhe kishte vepruar si në dispozitiv të këtij aktgjykimi ndaj të dëmtuarve edhe pse me të dëmtuarit ishin miq familjar pra i akuzuari ishte dhëndër i të dëmtuarve. Mbrojtësi i të akuzuarit thekson se i akuzuari N.TH. është i martuar me motrën e të dëmtuarve dhe kanë në jetë tre fëmijë të mitur, është i gjendjes sociale me të cilën ndihmë bënë përpjekje të i ushqej, shkolloj dhe të i veshi e mbathi nga të cilët dy nga fëmijët vazhdojnë shkollimin e rregullt. I akuzuari në fillim të shqyrtimit përgaditor dhe në atë kryesor ka shprehur bindjen e thellë se në rastin konkret ka gabuar por në të ardhmen nuk do të përsëris ndonjë gabim të tillë, të dëmtuarve në prani të Gjykatës u ka kërkuar falje për atë që kishte vepruar ndaj tyre, e duke qenë i bindur se në të ardhmen nuk do të veproj si më parë. Sipas ankesës dënimi i shqiptuar me gjobë në shumë prej 2.000 (dymijë) € dhe me obligimin që ti barti të gjitha shpenzimet e procedurës penale në të njëjtën kohë, atij dhe familjes së tij do ti vështirësohej edhe më tepër gjendja ekonomiko – sociale e në kuadër të kësaj edhe bashkëshortes së tij dhe tre fëmijëve të mitur, i akuzuari punon vetëm si punëtor krahu aty ku ka mundësi të punoj, përkundër dëshirës së tij për të përmbushur obligimet e caktuara nga gjykata, ai nuk do të jetë në gjendje të i paguaj ato obligime.

Gjykata e Apelit vlerëson se pretendimet e mësipërme ankimore të mbrojtësit të akuzuarit për shqiptimin e një dënimi më të butë, janë të bazuara, gjykata e shkallës së parë me rastin e shqiptimit të llojit dhe lartësisë së dënimit ka marrë parasysh dhe ka vlerësuar të gjitha rrethanat lehtësuese dhe rënduese konform nenit 69 të KPRK-së, me ç'rast si rrethana lehtësuese në anën e të akuzuarit ka marrë faktin se e ka pranuar fajësinë në tërësi, se nuk ka të dhëna e më parë ka qenë i gjykuar, se nuk ka të dhëna se zhvillohet procedurë tjetër penale ndaj tij, se gjykatës i premtoi se në të ardhmen nuk do të përsëris vepra të tilla po të tjera penale, se u kërkon falje të dëmtuarve, shpreh keqardhje, e pranon se ka gabuar, se është kryefamiljar, i martuar, mbajtës i familjes dhe baba i tre fëmijëve të mitur, të moshës 16, 12 dhe 9 vjeçare, ndërsa rrethana rënduese gjeti se kemi shkallë të lartë të dashjes gjatë kryerjes së veprës penale nga ana e të akuzuarit.

Një vlerësim të këtillë të rrethanave relevante për matjen e dënimit e pranon edhe kjo gjykatë, mirëpo kjo gjykatë gjen se në rastin konkret ka vend për shqiptimin e një dënimi më të butë. Prandaj, duke pasur parasysh rrethanat lehtësuese të cilat i ka vlerësuar dhe konstatuar gjykata e shkallës së parë, e posaçërisht rrethanën se i akuzuari e ka pranuar fajësinë, duke pasur parasysh faktin se nuk ka qenë më parë i dënuar dhe nuk ka të dhëna se zhvillohet ndonjë procedurë tjetër penale, u ka kërkuar falje të dëmtuarve, është kryefamiljar dhe baba i 3 fëmijëve të mitur, rrethana këto që sipas vlerësimit të kësaj gjykate paraqesin rrethana lehtësuese si dhe duke pasur parasysh se i akuzuari punon në treg dhe se me dënimin e shqiptuar nga ana e gjykatës së shkallës së parë do ti rrezikohej gjendja financiare familjare me çka do ti rrezikohej jeta normale e familjes së tij, bashkëshortes dhe fëmijëve të tij, ka bazë për shqiptimin e një dënimi më të butë, ngase kjo gjykatë vlerëson se dënimi i shqiptuar nga gjykata e shkallës së parë

me aktgjykimin e ankimuar është i ashpër, për çka të akuzuarit i shqiptoj dënimin sikurse në dispozitivin e këtij aktgjykimi, duke vlerësuar se i njëjti është në harmoni të plotë me shkallën e përgjegjesisë penale të të akuzuarit, intensitetin e rrezikshmërisë shoqërore të veprës së kryer penale, me shkallën e përgjegjesisë penale të të akuzuarës si ekzekutore dhe se ky dënim është në funksion të preventives gjenerale si dhe asaj individuale dhe se me dënimin e shqiptuar kryerësja do të parandalohet nga kryerja e veprave penale në të ardhmen, do të bëhet rehabilitimi i saj dhe do të ndikoj në përmbajtjen e personave tjerë nga kryerja e veprave penale, kjo gjykatë konsideron se me dënimin e shqiptuar të akuzuarit nga kjo gjykatë do të arrihet qëllimi i ndëshkimit i paraparë me dispozitat e neni 41 të KPRK-së.

Nga sa u tha më lartë, e në bazë të nenit 403 të KPPK-së, është vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS
PA1.nr.983/20, datë 14.12.2020

Bashkëpunëtori profesional,
Bujar Ahmeti

Kryetari i kolegjit,
Hashim Çollaku

Anëtarët e kolegjit:

Shqipe Qerimi

Ferit Osmani